

Fjala hyrëse, Promovimi i botimit të Akademik HIVZI ISLAMIT

I nderuar kryetar i Akademisë Mehmet Kraja,
I nderuar Nën kryetar Bajraktari,
E nderuara zonja Limani Sekretare Shkencore e Akademisë
Të nderuar akademikë,
Zonja dhe zotërinj,

Seksioni i Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në programin e vet, miratoi dhe realizoi në këtë vit, botimin e librit të Akademik Hivzi Islamit.

Sot kemi nderin që në mesin e kësaj audience dhe të mysafirëve të pranishëm, ta përurojmë librin e Akademik Hivzi Islamit

“DEMOGRAFIA E KOSOVËS EVOLUCIONI I POPULLSISË, MIGRIMET,
GJEOPOLITIKAT EKSPANSIONISTE SERBE DHE SPASTRIMET ETNIKE TË
SHQIPTARËVE”

Akademik Islami si njohës i mirë i proceseve dhe i rrjedhave demografike, edhe në këtë dorëshkrim ka një qasje shkencore moderne dhe profesioniste të bazuar në burimet më relevante të kohës dhe fushës, duke përthekuar komponentet substanciale të demografisë së Kosovës.

Akademik Islami me profesionalizmin e tij teorik, shkencor dhe me përvojën praktike, në këtë fushë ka bërë një punë kolosale në zbardhjen, evidentimin, analizën, interpretimin dhe prezantimin e rezultateve të studimit lidhur me gjendjen, trendet, faktorët që i nxisin ato, dhe me perspektivën e rrjedhës së këtyre proceseve.

Prandaj edhe në këtë libër ai sjell risi si nga qasja hartuese metodologjike duke ndjekur një qasje shkencore dhe duke konsistuar në përfshirjen e vështrimit intelektual dhe profesional të faktorit demografik

Prandaj, me këtë rast i falënderohemi dhe i dëshirojmë suksese në botime dhe projekte të tjera.

Njëkohësisht dëshiroj të falënderoj filantropin z. Lazim Destani, i cili financojë shtypin e librit “Demografia e Kosovës”.

Ju faleminderit!

Në Prishtinë, më 4 shkurt 2021

Justina Shiroka-Pula